



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 6, datë 30. 03. 2009

MBI

“NDRYSHIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 15.03.2001 PËR “MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT TEKNIK URBANISTIK”, (I NDRYSHUAR)”

Në mbështetje të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 25 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 për “Urbanistikën” (i ndryshuar); ligjit nr.8405, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.28, datë 15.03.2001 për “Miratimin e përbërjes së Këshillit Teknik Urbanistik” (i ndryshuar); pas shqyrtimit të propozimit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit Bashkiak nr.28, datë 15.03.2001 për “Miratimin e përbërjes së Këshillit Teknik Urbanistik” (i ndryshuar), bëhen ndryshimet si më poshtë:

I - Pika 2/a ndryshon sipas përmbajtjes që vijon:

2/a: - “Drejtori i Përgjithshëm i Kontrollit të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit - Kryetar”

II - Pika 2/b revokohet.

III - Pas pikës 2/l shtohet pika **2/m**, me këtë përmbajtje:

2/m: - “1 profesionist i fushës (arkitekt, urbanist, inxhinier ndërtimi) – anëtar”

2. Ngarkohen strukturat e Bashkisë së Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

KRYETAR